www.mergata-info.de
REVISTË PERIODIKE PËR MËRGATËN SHQIPTARE NË GJERMANI Nr.1, KORRIK 2024

# MËRGATA

REVISTË PERIODIK… SHQIPTARE NË GJERMANI



REVISTA
NR.1
PËR MËRGATËN SHQIPTARE NË GJERMANI

Blini Bauunternehmung

24 Afaristi UKË BLAKAJ Investon miliona në Kosovë

19 DRITON GASHI Ambasador i kulturës shqiptare në Gjermani

12 SHEMSEDIN BALAJ *Afarist i dalluar pronar i hotelit "Hotel in Laisen" Reutlingen*

14 Aktori i mirënjohur KASËM HOXHA

## FILANTROPI
# LAZIM DESTANI

wolf Bauunternehmen GmbH

SHALA FENSTER & TÜREN
• Beratung • Verkauf • Montage • Kundendienst • Reparaturen
Geschäftsführer Albert Shala
Tel.: 0911 81 06 664
Mob.: 0152 28 23 23 85
E-Mail: info@shala-fenster.de
Web: www.shala-fenster.de

HHL HOTEL IN LAISEN

BAUDEKORATION HASANI GmbH
Ihr Spezialist in der Fertighaus Branche

ARDIAN KOKOLLARI
ALLIANZ GENERALVERTRETUNG

EZ TROCKENBAU Malerfachbetrieb

FRUTEX GmbH
GOLDEN EAGLE ENERGY DRINK

RIDA BAU Meisterbetrieb




# Wir bauen für Sie

Fatlum & Fatbardh Blenishta



**Schlüsselfertigbau**
für Einfamilienhäuser, Doppelhäuser, Reihenhäuser und Mehrfamilienhäuser an.be.



**Ingenieurbau**
Verkehrsbauten wie Brücken, Stützwände und Tunnel werden von uns mit einem hohen Grad an Professionalität und Qualität gebaut.



**Sanierung**
Mit Fingerspitzengefühl werden Sanierungen, Umbauten und Aufstockungen – auch im laufenden Betrieb – von uns durchgeführt.

**KONTAKT AUFNEHMEN**
Sie haben Fragen zu Projekten, zu unserem Unternehmen oder möchten ein Termin vereinbaren ? Alle wichtigen Kontaktdaten finden Sie auf dieser Seite. Nutzen Sie auch unser Online-Formular für Ihre Kontaktaufnahme.
**info@blini-gmbh.de**

Herzlich Willkommen bei Blini Bauunternehmung GmbH



**Argjend Hasani**
Kryeredaktor

Revista Periodike për MËRGATËN SHQIPTARE NË GJERMANI
Nr. 1, Korrik 2024

Revista “MËRGATA”
Revista Online “Mergata-info.de”

Biblioteka:
Mërgata shqiptare në Gjermani

Kryeredaktor:
Argjend Hasani

Redaktor:
prof. Abdullah Troshupa

Dizajni Grafik:
Rrezart Fejzullahu

Bashkëpunëtorë:
Ahmet Pllana
Musa Mulolli
Xhafer Leci
Enver Zuka
Hamëz Dakaj

Botues:
Shtëpia Botuese “Lena Graphic” në Prishtinë
Portal informativ i MËRGATËS SHQIPTARE NË...

MËRGATA INFO

EDITORIAL

# LEXUES DHE BASHKATDHETARË TË NDERUAR!

Duke e parë rëndësinë e mërgatës sonë, rolin e saj në zhvillimet e shumta në rrugëtimin tonë historik, si: punën, aktivitetet, humanizmin dhe atdhedashurinë, vendosëm të botojmë Revisten “MËRGATA“ (mergata-info.de), që do të jetë botim periodik për mërgatën shqiptare në Gjermani.

Vlerësimi ynë është se, duke pasur parasysh kapacitetet tona dhe vendin ku veprojmë, punojmë e jetojmë, dhe nevoja për t’u informuar për zhvillimet dhe aktivitetet e shumta të mërgatës sonë në Gjermani, ishte arsyeja kryesore për të realizuar një projekt të tillë dhe të domosdoshëm për bashkatdhetarët tanë.

Misioni ynë është vizion dhe qëllim i përbashkët për të ofruar informacione të domosdoshme dhe të ndryshme sidomos për të arriturat e mërgatës shqiptare në Gjermani, nga fusha e letërsisë, arsimit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, artit, historisë, ekonomisë, shëndetësisë dhe sportit.

Revista “MËRGATA”, do tu ofrohet lexuesve në formë shtypi si dhe online, kështuqë do të jetë zëri i bashkatdhetarëve tanë në Gjermani dhe urë lidhëse në mes të mërgatës dhe vendlindjes.

Mendojmë se së bashku këtij qëllimi do t’ia dalim mbarë dhe në këtë mënyrë do ta ruajmë, kultivojmë gjuhën, kulturën, traditën, dhe dashurinë tonë për atdheun.

Me respekt
Argjend Hasani
Kryeredaktor

# FILANTROPI LAZIM DESTANI, VEPRIMTAR I SHQUAR NË MËRGATËN SHQIPTARE



## PERSONALITETE TË SHQUARA NË MËRGATË

Lazim Destani lindi në vitin 1954 në fshatin Bozovcë pranë qytetit të Tetovës, Maqedonia e Veriut. I shtyrë nga rrethanat lokale ekonomike si dhe nga dëshira për të gjetur mundësi më të mira përparimi, në moshën 16 vjeçare ai niset drejt Gjermanisë. Këtu u vendos në qytetin e Stolbergut ku e kishte dhe përkrahjen e dy vëllezërve të tij më të rritur të cilët tashmë i kishin bërë disa vite në këtë vend. Me personalitetin e tij të fortë dhe i bindur që fati duhet ndjekur në mënyrë aktive, Lazimi filloi të punojë por edhe të ndjekë shkollimin krahas punës. Në fillim ai punoi në një uzinë për përpunimin e drurit. Pas kualifikimeve që aimori gjatë disa viteve, Lazim Destanin e gjejmë të punësuar në kompaninë shtetërore për transport pasagjerësh, ASEAG me bazë në Ahen. Në këtë kompani ai punoi për disa vite me radhë (1982 - 1986) si shofer autobusi, ku ishte madje shoferi i parë jo-gjerman.

Viti 1987 ishte viti kur Lazim Destani e bëri hapin e tij të parë në botën e biznesit duke themeluar në Gjermani kompaninë e tij të udhëtimeve “Sharr Turist”. Kjo kompani për një kohë të shkurtër u rrit si biznes duke u shtrirë me përfaqësitë e veta gjithandej trojeve tona e duke ofruar udhëtime të rregullta direkte tokësore dhe ajrore mes vendeve të Ballkanit dhe atyre të Evropës Perëndimore, Gjermani, Zvicër, Belgjikë, Holandë e vende të tjera. Si kompani që krijoi linjat e para mes këtyre vendeve, “Sharr Turist” u bë urë lidhëse mes Ballkanit dhe Evropës Perëndimore, duke pasur si mision në radhë të parë t’u ofrojë pasagjerëve transport më të lehtë, më efikas, më të sigurt e më të këndshëm. Këtë shërbim inovativ








pasagjerët e çmuan shumë, sidomos emigrantët nga Ballkani pasi linjat direkte me vendlindjen dhe vendet ku punonin nuk i kishin pasur në dispozicion ndonjëherë më parë.

Suksesi i Lazim Destanit në biznes dhe kuptimi i tij për avantazhet që biznesi ofron në shoqëri e udhëhoqi atë drejt inkurajimit të shpirtit biznesor duke e bartur edhe te djemtë e tij. Tre djemtë e Lazim Destanit i morën në konsideratë këto mësime dhe ecën drejt suksesit, duke u bërë shembuj në fushat respektive, biznes dhe art. Ndër vite, kjo çoi drejt një grupi biznesesh familjare të rëndësishme dhe të suksesshme, që operojnë në nivel global. Kompania e udhëtimeve "Sharr Turist" u zhvillua dhe lulëzoi për 20 vite me radhë (1987 – 2007) dhe në vitin 2007, si rrjedhojë e ndryshimeve në treg dhe impaktit të tyre mbi modelin e biznesit të familjes, "Sharr Turist" u ristrukturua për t'u bërë pjesë e shërbimeve të bizneseve të familjes Destani.

Tashmë si pjesë e grupit të bizneseve familjare shquhet kompania 'Ecolog International',themeluar nga i biri Nazif Destani më 1998 në Gjermani. Në këtë kompani Lazim Destani prej shumë vitesh është Kryetar i Bordit Këshillëdhënës. Eksperienca e Lazim Destanit në biznes dhe shpirti i tij fisnik në kombinim me intelektin kognitiv dhe emocional të djemve të tij mund të konsiderohet si 'çelësi i suksesit' të grupit të bizneseve të familjes Destani.

Lazim Destani dhe tre djemtë e tij zotërojnë një numër biznesesh familjare, ndërsa operojnë në mbi 40 vende të botës, me mbi 18 000 të punësuar.

Meqenëse përmes biznesit Lazim Destani i kishte parë benifitet transformuese të hapjes së Ballkanit Perëndimor, ai shfaqi dëshirë që këtë mision tashmë ta bëjë përmes përpjekjeve filantropike, dhe krahas kësaj të vazhdojë me aktivitetet e tij sipërmarrëse duke ofruar mbështetje në formë konsultimesh për bizneset e familjes së tij. Botëvështrimi i Lazim Destanit ngërthen besimin se çdokush ka përgjegjësi personale për të dhënë kontribut për zgjidhjen e çështjeve shoqërore. Sot ai pjesën më të madhe të kohës e të energjisë ia dedikon zgjidhjes së çështjeve shoqërore në Ballkanin Perëndimor si dhe promovimit të këtij rajoni.



*Ecolog International - Tetovë*

I brengosur për papunësinë e rinisë në Ballkanin Perëndimor ai gjithmonë ka ofruar mundësi punësimi për dekada me radhë, që nga fillimi i karrierës së tij në biznes.

Sot, përmes kompanive që zotëron familja e tij, këto parime reflektohen dhe materializohen si në rajon ashtu dhe në të gjitha vendet ku ato operojnë.

Lazim Destani beson se arsimi, shkenca, arti, sporti dhe kultura janë vendimtare për zhvillimin e gjithmbarshëm të një vendi. Ai e konsideron si detyrë patriotike mbështetjen e vazhdueshme dhe progresive të këtyre sferave. Në këtë drejtim, ai ka krijuar partneritete, ka realizuar projekte e programe specifike bashkëpunimi mes kompanive të familjes së tij dhe shkollave, universiteteve e shoqatave sportive. Ai beson fort se familjet dhe shoqëritë janë më të fuqishme kur për qëllime dhe interesa të përbashkëta punojnë së bashku.

Në përputhje me këtë frymë, Lazim Destani ka nënshkruar disa Memorandume bashkëpunimi, ndër të cilat edhe me dy universitetet në Tetovë, me Universitetin "Fadil Sulejmani" dhe me Universitetin e Evropës Juglindore.

Ai gjithashtu e ka marrë nën përkujdesjen e tij financiare Klubin e Futbollit "Shkëndija". Ky klub nga Tetova, që nga koha kur i erdhi mbështetja e Lazim Destanit, ka shënuar rezultate të larta duke u bërë ndër klubet më të suksesshme të rajonit e duke arritur rezultate të larta edhe në kompeticionet evropiane.



Lazim Destani ndjek rrugë të ndryshme për t'i bërë bashkë njerëzit dhe institucionet nga disiplina të ndryshme duke synuar partnerizimin e tyre për t'i shërbyer sa më mirë zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendeve tona.

Në shërbim të këtij misioni ai merr pjesë në mënyrë aktive në takime e konferenca ndërkombëtare për promovimin dhe ngritjen e ndërgjegjes rreth bashkëpunimeve të kësaj natyre.

Lazim Destani është pjesë e strukturave drejtuese të disa subjekteve të diasporës sonë, ndër të cilat:

- Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës Shqiptare,
- Kryetar Nderi i Rrjetit Global të Bizneseve të Diasporës,
- Kryetar Nderi i Dhomës së Bizneseve të Diasporës, etj..

Lazim Destani dhe bashkëshortja e tij Rasimja kanë tre djem, Nazif, Selim dhe Blerim Destani. Familja Destani jeton në Tetovë si dhe në Dyzeldorf të Gjermanisë. Lazim Destani është adhurues i poezisë, historisë dhe fotografisë, ndërsa e ndjek me pasion futbollin si dhe risitë që sjell teknologjia e informacionit.



KF "Shkëndija" duke festuar titullin Kampion-Tetovë 2018




*Këshilli Koordinues i Diasporës – Tiranë 2019*



*Unioni Global i Bizneseve të Diasporës Shqiptare–Vienë 2014*




*Lazim Destani me ekipin e Shkëndijës-Tetovë 2013*

# AKTIVITETI KOMBËTAR, FILANTROPIK E HUMANITAR I LAZIM DESTANIT



Lazim Destani është një personalitet modest e zemërgjerë, njeri humanitar dhe filantrop i njohur e i shquar në trojet shqiptare dhe më gjerë. Ky dimension i Lazim Destanit është brumosur nga edukata familjare e përcjellë brez pas brezi dhe me rrënjë të thella tek tradita e popullit paqësor shqiptar. Ai vjen nga një familje bujare nga katundi Bozovcë që gjendet në zonat e thella të malësisë së Sharrit, ku e kaloi dhe fëmijërinë e tij.

Duke e zhvilluar dhe zgjeruar biznesin e tij familjar, Lazim Destani në ndërgjegjen e tij njëkohësisht e ka zhvilluar dhe ndjenjën e përgjegjësisë shoqërore, humanitare e atdhetare.

Përderisa filantropinë e kuptojmë si një dashuri për njerëzimin, në sensin e përkujdesjes ndaj njerëzve në nevojë si dhe ngritjes e përmirësimit të cilësisë së jetës në përgjithësi, atëherë Lazim Destani është një shembull tipik i aktiviteteve dhe veprave filantropike.

Nga biznesi familjar i Lazim Destanit për dekada me radhë mijëra punëtorë mbajnë familjet e tyre. Aktivitetin e tij filantropik e atdhetar ai e ka praktikuar në vazhdimësi. Që nga hapat e parë të karrierës së tij në biznes ai u ka dhënë përkrahje të pakursyer aktiviteteve e projekteve të shumta nga sfera e arsimit, shkencës, artit, kulturës, sportit e të tjera. Aktiviteti lobues për çështjen kombëtare gjithmonë ka qenë dhe vazhdon të mbetet në vëmendjen dhe në zemrën e tij si një nga detyrat me përgjegjësi të lartë por edhe pasion i veçantë.

Shumë intelektualë e veprimtarë të shquar të çështjes kombëtare, për realizimin e aktiviteteve të tyre patriotike e lobuese në vendet perëndimore, e kanë pasur të njohur emrin e tij, si njeriun tek i cili gjithmonë e kanë gjetur mbështetjen e nevojshme.

Ndihmat humanitare dhe bamirësia në mënyrë të veçantë gjithmonë kanë qenë në vëmendjen e Lazim Destanit. Dora e tij bujare ka arritur të ngroh zemrat e mijëra e mijëra njerëzve, në rrafsh lokal dhe global, duke u dalë në ndihmë si ballkanasve ashtu dhe evropianëve e aziatikëve, afrikanëve e amerikanëve, pa dallim etnie, feje, race, gjuhe apo kulture. Kjo flet edhe për dimensionin filantropik universal të Lazim Destanit duke reflektuar qëndrimin e tij për një botë më të mirë për të gjithë.

Si periudhë më emocionuese për ta theksuar në këtë shkrim është koha e hapjes së kufirit shqiptar pas diktaturës. Në këtë kohë grupet e artistëve nga Shqipëria shpërthyen me koncerte dhe aktivitete e tjera kulturore nëpër qytetet e Maqedonisë e të Kosovës dhe më pas edhe nëpër Evropë. Për realizimin e këtyre aktiviteteve ata e kishin të domosdoshmetë siguronin mbështetje financiare, dhe për këtë ishte i padiskutueshëm vullneti i Lazim Destanit, i cili në këtë kohë kishte arritur të ngjitej lart me biznesin e tij me kompaninë e udhëtimeve, "Sharr Turist". Mund të themi që sponsorimet e kësaj kohe përbëjnë themelet mbi të cilat u ngrit aktiviteti filantropik i Lazim Destanit, për të arritur tek përmasat e sotme globale.

Ai dhe familja e tij, një pjesë nga fitimet e tyre vjetore rregullisht e ndajnë për qëllime humanitare apo për mbështetjen e iniciativave edukative dhe kulturore.

Në mënyrë sistematike ai për çdo vit ka mbështetur projekte të ndryshme, duke i ardhur në ndihmë popullatës, ndërsa në veçanti ka dërguar kontingjente ndihmash në zonat që janë goditur nga fatkeqësitë natyrore si tërmete, përmbytje, apo së fundmi rasti i pandemisë së shkaktuar nga Covid-19.

Sa për ilustrim, vetëm gjatë vitit 2020 Lazim Destani ka dhënë kontribut të çmueshëm në zbutjen e pasojave të pandemisë. Përmes disa projekteve njëri pas tjetrit, në mënyrë të veçantë i ka dhënë mbështetje shëndetësisë, arsimit si dhe familjeve në nevojë. Për insti-



*Unioni i Bizneseve Shqiptare në Gjermani me mikun e shqiptarëve, Ambasadorin William Walker -Dyzeldorf 2017*

tucionet e shëndetit publik në trojet tona ai ka dhuruar kontingjente me pajisje spitalore dhe teste për Covid-19.

Gjatë këtij viti, institucioneve të arsimit në trojet tona u ka dhuruar me mijëra tabletë për t'ua mundësuar ndjekjen e procesit mësimor online nxënësve që vijnë nga familjet në nevojë, si dhe pafund mbështetje me artikuj ushqimor dhe higjienik për të ndihmuar familjet me nevoja sociale.

Lazim Destani ka pranuar disa çmime dhe tituj nderi nga autoritete të larta kombëtare e ndërkombëtare:

- "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në vitin 2012;
- "Medalja Presidenciale e Meritave" nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në vitin 2015;
- "Qytetar Nderi" nga Kryetari i Komunës së Tetovës, në vitin 2011
- "Shqiponja e Artë e Diasporës" nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, në vitin 2019;
- "Ambasador i Kombit"nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, në vitin 2019;
- "Doctor Honoris Causa" nga Universiteti i Tetovës – 'Fadil Sulejmani', në vitin 2017.
- "Flamuri Amerikan" (që në nderim të Lazim Destanit u valëvit mbi Selinë e Kongresit Amerikan)nga Kongresisti dhe miku i madh i shqiptarëve, Eliot Engel , në vitin 2017.




*Lazim Destani pranon Flamurin Amerikan bashkë me Çertifikatën shoqëruese nga Kongresisti dhe miku i madh i shqiptarëve, Eliot Engel*




ALLIANZ GENERALVERTRETUNG

Ulmen Str. 8
40476 Düsseldorf

ARDIAN KOKOLLARI
ALLIANZ GENERALVERTRETUNG

Tel.: 0211 46885144

ardian.kokollari@allianz.de

www.Allianz-Kokollari.de

**Ardian Kokollari, partneri juaj serioz në biznes. Ju ofron sigurime të ndryshme dhe financa në realizimin e ëndrrës suaj.**

# SHEMSEDIN BALAJ, AFARISTI I SUKSESSHËM SHQIPTAR NË SEKTORIN E HOTELIERISË

Afaristi i suksesshëm Shemsedin Balaj, rrjedhë nga një familje bujare me tradita atdhetare nga fshati Rakosh i Istogut. Si pasojë e përndjekjes dhe represionit serb, në vitin 1991, si shumë bashkatdhetarë të tjerë, kishte emigruar në Gjermani. Ai, nuk qëndroi duarkryq, fillimisht për pak kohë ka punuar në sektorin e ndërtimtarisë dhe që nga viti 1995 deri 2000, ka punuar në "Deutsche Post AG".



*Shemsedin Balaj, pronar i hotelit "HOTEL IN LAISEN"*

-Ndërsa, më pas ka hapur biznesin e tij, Kompaninë "Taxi XXL" në Reutlingen deri në vitin 2018, ku kishte punësuar 30 punëtorë. Ai, njëkohësisht është marrë me imobilje, ku për një kohë të shkurtër ka blerë pesë objekte me 24 apartamente për banim. Ndërsa, në vitin 2014 bleu edhe katër objekte të tjera në arealin ku ndodhet hoteli, me 30 apartamente të tjera, gjë që më vonë u bë i mundur investimi tjetër i radhës, siç ishte ndërtimi i hotelit.





-Afaristi Shemsedin Balaj, pas një pune dhe përkushtimi relativisht të gjatë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, vendosi që të ndjekë ëndrrën e tij në konkretizimin e idesë së kahmotshme në sektorin e hotelierisë, për ndërtimin e një hoteli.

-Pas ndërtimit të hotelit modern gjatë vitit 2018/19, në Reutlingen, solemnisht u përurua hoteli me emrin "Hotel in Laisen" në muajin tetor të vitit 2019. Hoteli me standarde të larta, siç është, "Hotel in Laisen" në Reutlingen në pronësi të afaristit Shemsedin Balaj, është tejet modern dhe ka një kapacitet prej 27 dhomave, prej të cilave ofron për mysafirë: 9 dhoma për një person, 12 dhoma për çifte, 4 dhoma për familje dhe dy suita tejet moderne. Në këtë hotel ofrohen shërbime të mrekullueshme nga stafi dhe punëtorët e hotelit. Kryesisht në "Hotel in Laisen", frekuentojnë shumë mysafirë, e posaçërisht, ata të kategorisë "Business Hotel", sepse pjesa dërmuese e mysafirëve - klientëve janë afaristë dhe punëtorë të ndryshëm.

-Në kuadër të hotelit gjendet edhe restoranti me një kapacitet prej 110 mysafirëve, që aktualisht udhëhiqet nga një kuzhinier tetovar, i cili ofron specialitete të shijshme nga kuzhina autoktone shqiptare dhe ballkanike.

HOTEL IN LAISEN

Afaristi i suksesshëm, z.Shemsedin Balaj, në pronësi ka edhe stacionin për karrigimin e automjeteve me rrymë elektrike, të njohur si: "Elektro Ladestation", për automjete, e cila ka një kapacitet deri në 16 stacione mbushëse (Ladestation).

Aktualisht janë në funksion 6 pika karrikimi-mbushjeje me kapacitet 22 KW/h. Vlen të theksohet se kjo "Elektro Ladestation" është e para dhe aktualisht e vetmja e llojit të tillë në këtë regjion dhe më gjerë.
Afaristi Shemsedin Balaj, është i afërt, dhe tejet ambicioz, dhe është një fakt dhe dëshmi e fortë, se me punë dhe korrektësi, arriti që të realizoj me sukses ëndrrën e tij për hapjen e hotelit dhe stacionit për karrigimin e automjeteve, të cilat me shumë përkushtim dhe me sukses i drejton.





# KASËM HOXHA

## AKTORI I MIRËNJOHUR SHQIPTAR NË GJERMANI

Kasëm Hoxha lindi në kryeqytetin shqiptar të Tiranës gjatë diktaturës komuniste-staliniste të Enver Hoxhës. Ai u rrit atje me familjen e tij si një nga pesë fëmijët në rrethana të vështira dhe përjetoi tiraninë e regjimit të Hoxhës. Edhe si fëmijë, Hoxha dëshironte të bëhej aktor. Nga mosha katër deri në gjashtë vjeç, Hoxha jetoi me gjyshërit e tij për arsye familjare dhe u kthye në familjen e tij kur filloi shkolla. Babai i tij vdiq nga kanceri në mushkëri kur Kasem Hoxha ishte fëmijë. Në moshën 15-vjeçare filloi të punonte në një fabrikë që prodhonte tulla silikate, ku punonte me tre turne. Ai ndoqi edhe një shkollë për të rinjtë që punonin, të cilën e përfundoi me sukses. Që në moshën 16-vjeçare ai është marrë me vetëdije edhe me situatën politike në Shqipëri.

Në moshën 19-vjeçare, ai u thirr për dy vjet shërbim ushtarak, të cilin e bëri nga viti 1988 në veri të Shqipërisë, ku u vendos në mes të maleve në pjesën më veriore të vendit. Për shkak të aftësive dhe shkathtësisë së tij në kodin Morse dhe telegrafi, ai u punësua në stacionin telegrafik. Në fillim të korrikut 1990, menjëherë pas lirimit nga shërbimi ushtarak, ai iu bashkua një grupi studentor të protestës dhe rezistencës dhe, pa i ditur familja për planet e tij, u arratis në Ambasadën Gjermane në Tiranë si viktimë e përndjekjes politike, ku kaloi rreth një javë, mbeti i izoluar nga bota e jashtme në temperaturat e larta të verës, pjesërisht pa ushqim dhe pije, si dhe pa kujdes shëndetësor dhe mjekësor me rreth 3000 refugjatë të tjerë, në një hapësirë të mbyllur pa ambiente sanitare. Me një transport refugjatësh të organizuar nga NATO, ai ishte më 8 dhe 9 korrik të vitit 1990 në qytetin port të Durrësit, 40 kilometra larg, ku për herë të parë mori një traget përtej

detit Adriatik për në Brindisi, Itali. Më pas vazhdoi me tren nëpërmjet Zvicrës për në Gjermani. Ndalesa e tij e parë në Gjermani ishte Regensburg, ku qëndroi për një muaj.

Më pas ai erdhi në Aschaffenburg.
Punën e parë e mori së bashku me disa bashkatdhetarë në fabrikën e letrës në Aschaffenburg/Damm, ku fillimisht u punësua për të pastruar makineritë. Ai më vonë kaloi brenda kompanisë për t'u bërë një prodhues letre. Në vitin 1993 ai u takua me të dashurën dhe më vonë partneren e tij, familja e së cilës e inkurajoi në zhvillimin e tij të mëtejshëm, veçanërisht për aktrim. Hoxha përfundimisht përfundoi një praktikë si teknik dentar.

Në vitin 1999 ai gjithashtu përfundoi një seminar në Metod Acting (Lee Strasberg/ Uta Hagen) me John Costopoulos në Actor's Studio në New York City.





"

Kasëm Hoxha ndoqi ëndrrën e tij për t'u bërë aktor ndërsa ishte ende në punë. Nga viti 1999 deri në vitin 2002 ai u trajnua si aktor në Actor's Company në Aschaffenburg. Atje kreu një seminar aktrimi nën regjisorin Torsten Stoll, i cili më vonë u bë mësuesi i tij i aktrimit dhe promovoi karrierën e tij, për të përcaktuar përshtatshmërinë e tij artistike për këtë profesion.

"



# Aktori Kasëm Hoxha me Presidentin e Republikës Federale të Gjermanisë, Frank Walter Steinmeier gjatë vizitës në Shqipëri

Nga viti 2000 deri në vitin 2004 ka pasur angazhime në teatër mbarëkombëtar. Rolet e tij të para skenike përfshinin rolin e Willy Loman në Death of a Salesman (drejtuar nga Torsten Stoll).

Në 2001 dhe 2002 ai bëri paraqitje të ftuar në dy produksione në "Theatre Spessartgrotte" në Gemünden-Langenprozelten, ku luajti në komedinë The Cactus Blossom (si Norbert dhe Herr Cochet, regjisor: Susanne Frey) dhe si pronari në Minna von Barnhelm (regjisor: Jurek Makarowski) u pa me Isabel Mergl si partnere. Në sezonin 2002/03 ai luajti rolin e vrasësit Toni në komedinë gangsterike të Chazz Palminteri, Besniku në "Erthaltheater" në Aschaffenburg, përsëri me regji të Torsten Stoll. Kasëm Hoxha tani punon rregullisht si aktor i filmit dhe televizionit. Ai luan shpesh në filma krimi dhe aksion.

Ne vitin 2021, aktori Kasëm Hoxha është aktori i parë që zgjidhet si anëtar në një akademinë shtetërore të artistëve gjermanë, në „Deutsche Film Akademie"

Falë angazhimit dhe punës së mire dhe të palodhshme si aktor deri më tani, ai u përzgjodh në vitin 2022, në jurine kryesore të festivalit me prestigjioz botëror të njohur me emrin „FilmFest Cottbus" që është festivali më i madh në botë për Evropën Jug-Lindore.



*Aktori shqiptar Kasëm Hoxha, ishte i përzgjedhuri i presidentit gjerman Steinmeier, për ta shoqëruar atë gjatë vizitës katër ditore në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut në vitin 2022*

JK | KRYEZIU
Steuerberatung



**Diplom-Betriebswirt Jahir Kryeziu**
**Steuerberater**
*Bockenheimer Anlage 46*
*60322 Frankfurt am Main*

**Tel.: +49 69 505064150**
**info@kanzlei-riedberg.de**
**www.kanzlei-riedberg.de**

**Shërbimet kryesore ligjore, tatimit dhe kontabilitetit përfshijnë:**

- Asistencë ligjore biznesi
- Ngritje biznesi
- Hartim kontratash, kontrata për punonjësit dhe kontrata tjera të biznesit
- Asistencë në zbatim dhe menaxhim të kontratës
- Udhëzim-zbatim për tatimet
- Zgjidhje të strukturimit të tatimeve
- Shërbime të këshillimit të transferimit të çmimeve
- Regjistrim biznesi
- Shërbime pajtueshmërie tatimi
- Tatim në të ardhura të korporatës
- Shërbime të pajtueshmërisë së TVSh-së
- Shërbime të pajtueshmërisë të tatimeve personale
- Shërbime kontabiliteti
- Shërbime pagash
- Procedim të dhënash
- Përgatitje raportesh financiare.



# DRITON GASHI,
## AMBASADOR I VLERAVE INTELEKTUALE SHQIPTARE NË GJERMANI

# DRITON GASHI, AMBASADOR I VLERAVE NTELEKTUALE SHQIPTARE NË GJERMANI

Driton Gashi u lind në Prishtinë në vitin 1975. Në moshën pesëmbdhjetë vjeçare emigron me familje në Gjermani. Ka studiuar për gjuhësi dhe pedagogji në Universitetin e Bochum-it dhe punon si pedagog shkolle dhe këshilltar pedagogjik në një kolegj për të rritur në qytetin Dortmund. Studimet pasuniversitare i ka mbaruar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Hagen-it dhe ka marrë titullin akademik "Magjistër i Drejtësisë", "Master of Mediation" (MM), (ndërmjetës privat dhe jashtëgjyqësor në raste të konflikteve familjare). Nga viti 1993 punon për dhjetëra gjykata dhe institucione tjera të larta shtetërore si përkthyes i betuar dhe i autorizuar gjyqësor për gjuhën gjermane dhe shqipe.

Driton Gashi mirret edhe me përkthime letrare. Ka përkthyer nga shqipja në gjermanisht poezi nga shumë krijues shqiptarë. Përmbledhja me poezi e autorit Çerkin Bytyçi e përkthyer në gjermanisht është botuar në Rottweil, Gjermani, në vitin 2020.



Autori Driton Gashi gjatë promovimit të librit në Laurentiushaus
Foto: Gisela Schwarz

Përmbledhja me këngë popullore dhe të lehta nga të gjitha trevat tona "Këngë të paharruara shqiptare" (Prishtinë, 2011) është libri i tij i parë në gjuhë shqipe. Në vitin 2019 ka botuar përmbledhjen me ese, kolumne edhe reportazhe "Rrugëtim publicistik". Në gjuhën gjermane Driton Gashi ka botuar disa punime shkencore në fushën e pedagogjisë ndërkulturore.

Në vitin 2021 Driton Gashi ka botuar librin e tij të parë autobiografik-eseistik në gjuhën gjermane "Mit dem Doppeladler im Ruhrpott" (Me shqiponjën me dy krena në rajonin e lumit Ruhr). Shtëpia botuese "Bücherplantage" në Gelsenkirchen i ka ndihmuar autorit të plasohet në tregun e librave në Gjermani dhe të merr vëmendjen e duhur si autor.

Deri tani Driton Gashi ka patur afër 15 prezantime të suksesshme të këtij libri në krejt Gjermaninë dhe në Kosovë. Edhe këtë vit tashmë ka të prenotuara 7 prezantime, ndër të tjera edhe në qarqe akademike, si për shembull në Humboldt-Universität në Berlin.

Në vitin 2022 ka botuar librin publicistik "Sapere aude" (Ndiq zërin e ndërgjegjes tënde) në shtëpinë botuese "IDEA Multumedia", pronar i të cilës është gazetari, autori i filmave dokumentarë dhe autori Nuhi Bytyçi. Libri u përurua në Prishtinë verën që shkoi dhe pati jehonë të madhe mediale.



Driton Gashi, ka publikuar tri albume me muzikë të lehtë shqiptare dhe ndërkombëtare, "Driton Gashi" (2000), "This is my life" (2010) dhe "Shtegtar-Wanderer (2017)






Me muzikë mirret që nga fëmijëria dhe deri tani ka publikuar tri albume me muzikë të lehtë shqiptare dhe ndërkombëtare, "Driton Gashi" (2000), "This is my life" (2010) dhe "Shtegtar-Wanderer (2017).

Është bashkëpunëtor i rregullt i disa gazetave dhe revistave shqiptare dhe gjermane, ku ndër të tjerash shkruan lidhur me aktivitetin kulturor të mërgatës shqiptare si dhe fenomenin dhe pasojat e migrimit. Poashtu është përkrahës i madh i Shkollës Shqipe në Gjermani si ekspert i dygjuhësisë, si ndërmjetës mes komunitetit shqiptar dhe palës gjermane si dhe në rolin e lektorit dhe përkthyesit gjatë përpilimit të teksteve shkollore.
Driton Gashi flet dhe shkruan në nivel akademik gjuhën shqipe, gjermane, angleze dhe serbokroate. Poashtu flet dhe shkruan mirë edhe gjuhën spanjolle.

EG PROJEKTBAU GmbH










info@gashi-akustikbau.de

www.gashi-akustikbau.de

Inh: Edis Gashi

Burgbongert 31
41199 Mönchengladbach
-Odenkirchen
Tel: 02166 217 44806
Fax: 02166 2174 807

EZ TROCKENBAU
Malerfachbetrieb









**EZ TROCKENBAU**
Malerfachbetrieb

info@ez-trockenbau.de

https://www.ez-trockenbau.de/

Tel.: 0202 295 36686
Mobil.: 0174 753 9963

Blumenstr. 30
42119 Wuppertal

Inh: Enver Zuka

# UKË BLAKAJ






# AFARISTI I SUKSESSHËM NË GJERMANI UKË BLAKAJ INVESTON EDHE NË KOSOVË

Afaristi Ukë Blakaj, djali i Mësuesit Dëshmor të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) Mustafë Blakaj, i cili nuk qëndroi duarkryq, ai i qëndroi besnik amanetit të babait, që edhe përkundër emigrimit mos ta harroj Kosovën. Kështu edhe veproi Uka, ai sot është një afarist i suksesshëm në Gjermani, është pronar i pesë bizneseve atje, por që në zemër gjithnjë e ka atdheun, kështu që në vendlindjen e tij në Istog të Kosovës, i themeloi disa ndërmarrje. Sot, në Istog aktivitetin afarist me sukses e zhvillojnë bizneset, si Ndërmarrja "Moler Kroni", ku ka të punësuar afro 30-të punëtorë, pastaj depoja me po të njëjtin emër që merret me shitjen e bojrave, llaqeve dhe materialit për suvatim. Ai ka investuar edhe në sektorin e hotelerisë, ku ka hapur Hotel-Restorantin tejet komfor "Scanderbeg", afër burimit të Istogut. Në Hotel-Restorant i ka të punësuar afër 20 punëtorë.

Në fabrikë aktualisht janë të punësuar afro 80 punëtorë dhe së shpejti pritet të punësohen edhe dhjetëra punëtorë të tjerë, gjë që është një ndihmesë e madhe për zvogëlimin e numrit të madh të papunëve në Kosovë. Synimi i tij është të punësojë të rinjtë, në mënyrë që ata të mos largohen nga Kosova.
Kështu që shtëpitë e parafabrikuara, tanimë gjejnë plasmanin e tyre si prodhime me standarde të larta teknike në tregun gjerman me siglen, Produkt "Made in Kosova" në Gjermani. Produktet e prodhuara në Fabrikën "WOLF GmbH" në Kosovë po eksportohen në Gjermani, pasi që kërkesat në tregun gjerman janë të mëdha, dhe kapacitetet prodhuese të fabrikës së tij janë të larta. Duke parë trendin e zhvillimit, suksesit këto produkte së shpejti do të plasohen edhe në tregun e Bashkimit Evropian, sidomos në Austri, Belgjikë, Luksemburg, Holandë, Francë, etj. Investimet milionëshe për ndërtimin e kësaj fabrike, janë tërësisht private.
Ukë Blakaj, është kryetar i Unionit të Bizneseve Shqiptare dhe Gjermane në Gjermani, dega e Hesenit, Rheinland-Pfalz-it dhe Saarland-it.
Puna, përkushtimi, korrektësia, efikasiteti dhe kualiteti, janë garantë më e mirë për sukseset e njëpasnjëshme të afaristit të suksesshëm, Ukë Blakaj!




*Afaristi i suksesshëm Ukë Blakaj, pronar i Kompanisë "WOLF Bauunternehmen GmbH" në Fulda në ceremoninë e përurimit të Fabrikës për prodhimin shtëpive të parafabrikuara në Sinajë të Istogut*




*fabrika për prodhimin shtëpive të parafabrikuara "WOLF GmbH" në Sinajë të Istogut*

Wolf
HOTEL - RESTAURANT
Zur Linde




Wernaustraße 7 - 36093 Künzell, Deutschland

hotelzurlinde@wolfgruppe.com

www.wolfhotel-zurlinde.de

+49 661 34167


HERZLICH WILLKOMMEN

# VËLLËZËRIT BLENISHTA, STORJE E AFARISTËVE TË SUKSESSHËM NË GJERMANI

Fatbardh Blenishta, së bashku me vëllaun Fatlumin janë ndër afaristët më të suksesshëm në mërgatën shqiptare Gjermani. Ata janë partnerë serioz në afarizëm, sot drejtojnë kompani prestigjioze në ndërtimtari për një kohë të gjatë dhe me një përvojë të madhe në industrinë e ndërtimit në Gjermani.
Fillimisht në afarizëm parapriu me punë dhe suksese të shumta, babai i tyre z.Rysh Blenishta nga Ferizaj, i cili më shumë se 50 vite jeton dhe punon në Gjermani. Afaristi i suksesshëm z.Rysh Blenishta, pas themelimit të kompanisë me sukses, për një kohë e ka drejtuar kompaninë, kështu që me pensionimin e tij, këtë biznes e drejtojnë dy djemtë e tij, dy vëllezërit Fatbardh dhe Fatlum Blenishta. Dy djem të rinj, ambicioz dhe të respektuar në mërgatën shqiptare në Gjermani.
Fatbardhi u lind në Ferizaj, pasi që babai i tij, Rysh Blenishta që nga viti 1970, punonte në Gjermani (ishte aktivist i dalluar në demonstratat e vitit 1981), si fëmijë i vogël, në moshën pesëvjeçare, së bashku me familjen e tij në vitin 1990, emigrojnë nga vendlindja dhe i bashkohen të atit në Gjermani.
Fatbardhi, shkollimin fillor e kreu në Windeck Herchen, ndërsa shkollimin e avancuar në Weiterführende Schule në Hennef.
Në vitin 1997, babai Rysh Blenishta, themeloi Kompaninë

RB Blini GmbH
Bauunternehmung

"R.B. BAU Bauunternehmen" në Windeck Herchen afër Bonnit, ndërsa nga viti 2002, Fatbardhi bëhet njëri nga pronarët e kompanisë.
Kjo kompani me sukses në kontinuitet ka zgjeruar kapacitetet e saj në lëmin e ndërtimtarisë së lartë, dhe si rezultat i këtij zgjerimi është themeluar kompania tjetër, "BLINI Bauunternehmung GmbH".
Në vitin 2008, Fatbardhi në fazën parapërgatitore për të drejtuar kompaninë "R.B. BAU Bauunternehmen GmbH", pasi që babai në vitin 2012 do të pensionohej, kreu shkollimin e avancuar profesional, si Mjeshtër për Ndërtimtari në lëmin e murosjes dhe betonimit (Weiterbildung als Maurer-, Betonbaumeister në HWK Köln).
Kështu që nga viti 2012, pronësia e Kompanisë Ndërtimore "R.B. BAU Bauunternehmen GmbH" dhe "BLINI Bauunternehmung GmbH", trashëgohen nga Rysh Blenishta, tek djemtë Fatbardh dhe Fatlum Blenishta.



**Afaristët e suksesshëm, Vëllezërit Fatlum dhe Fatbardh Blenishta**

Fatbardhi u lind në Ferizaj, pasi që babai i tij, Rysh Blenishta që nga viti 1970, punonte në Gjermani (ishte aktivist i dalluar në demonstratat e vitit 1981), si fëmijë i vogël, në moshën pesëvjeçare, së bashku me familjen e tij në vitin 1990, emigrojnë nga vendlindja dhe i bashkohen të atit në Gjermani.
Fatbardhi, shkollimin fillor e kreu në Windeck Herchen, ndërsa shkollimin e avancuar në Weiterführende Schule në Hennef.



*Afaristi i suksesshëm*
**Fatbardh Blenishta**



Kompania në fjalë ka zgjeruar mëtutje gamën e punimeve në sektorin e ndërtimeve të vrazhda, ndërtimin e objekteve të gatshme sipas sitemit me çelësa në dorë, ndërtimin inxhinierik (me mbikëqyrjes inxhinierike) dhe sanime të objekteve të ndryshme ndërtimore.

-Përveç tjerash, afaristi i suksesshëm shqiptar në Gjermani, ka ndjekur edhe seminare dhe përgatitje tjera të shkollimit profesional, si: Menaxher i certifikuar i ndërtimitarisë (TÜV Geprüfter Bauleiter), Vlerësuesi kualifikuar në ndërtimtari (Gutachter), Ekspert i ndërtimtarisë (Sachverständiger), etj.

Fatbardh Blenishta, përveç se drejton me sukses dy kompanitë së bashku vëllaun e tij.

Ata kanë investuar edhe në biznese tjera si investitor në energjinë solare, si paneleve solare të sistemit të njohur Photovoltaik dhe investime në industrinë e ndërtimit të objekteve banesore dhe të apartamenteve në qytetin e Ferizajit si dhe investime të tjera në sektorin e ndërtimeve në Kosovë.

-Afaristi Fatbardh Blenishta është një afarist i suksesshëm në Gjermani, ai së bashku me vëllaun Fatlumin, me një përkushtim të jashtëzakonshëm, me punë, sinqeritet dhe efikasitet arrijnë që projektet e punimeve të ndryshme në lëmin e ndërtimtarisë t'i realizojnë me një kualitet të lartë. Prandaj, si rezultat i punëve të realizuar me sukses, tanimë së fundmi në pronësi kanë edhe Kompaninë "Wilhelm Petzer GmbH Co. KG" në Koblenz. Përveç tjerash afaristi Fatbardh Blenishta, ofron konsulta për themelimin dhe menagjimin e ndërmarrjeve biznesore.



